



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:085014
Datë: 18.06.2024
Numri i dokumentit: 05709510

K.DH.SH.II.nr.371/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, me seli në Prizren, kundër debitorit “Posta e Kosovës” SH.A., me NUI: 811285205, me seli në rr. “28 Nëntori” nr.4, në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.698/23 të datës 26.10.2023, me datën 18.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “Posta e Kosovës” SH.A., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.698/23 të datës 26.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.698/23 të datës 26.10.2023, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Posta e Kosovës” SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.83/2023, i datës 05.04.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Mehdi Reshani.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbare, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqit kreditori edhe pse të njëjtën e ka pranuar me datën 12.01.2024.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbare (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, me seli në Prizren, ka paraqitur propozim për përmbare ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbare, Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr. 349/2022, të datës 28.12.2022, me të cilën është detyruar debitori që t'ia paguaj kreditorit në emër të masës ndëshkimore shumë prej 1,000.00 € (njëmijë euro, përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e kreditorit, ose pasurisë së debitorit deri në bartjen e shumës në tërësi.

Përmbareuesi privat Mehdi Reshani sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbare P.nr.83/2023, i datës 05.04.2023, ka lejuar përmbaremin ndërsa debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor duke kundërshtuar tërësisht urdhrin e lejuar për përmbare, nga fakti se dokumenti për ekzekutim siç është Vendimi Nr. 349/2022 i datës 28.12.2022 nuk përbën titull ekzekutiv dhe i njëjti nuk konsiderohet dokument i besueshëm, ashtuqë lejimi i këtij urdhri përmbare nuk ka tipare të përmbareueshmërisë, përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbare. Më tutje ka shtuar se nuk ka pranuar ndonjë vendim të organit të shkallës së dytë të kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovet si i bazuar prapësimi i debitorit, ta anulohet urdhri për përmbare, si dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet e procedurës përmbare.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, prapësimin e debitorit e ka konsideruar si të pabazuar dhe se pretendimet e tij se vendimi i kreditorit nuk ka titull ekzekutiv nuk qëndron, ngase Vendimi nr. 349/2022 ka titull ekzekutiv dhe përmbartim nga data 18.01.2023. Më tutje ka shtuar se debitori e ka pranuar vendimin e lartcekur dhe ndaj të cilit ka ushtruar ankesë pas afatit prej 8 ditësh nga këshilla juridike. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbartim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.698/23 të datës 26.10.2023, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Posta e Kosovës” SH.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartim P.nr.83/2023, i datës 05.04.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në rastin konkret Vendimi Nr. 349/2022 i datës 28.12.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri”, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: “Vërtetimin për përmbartueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”, ngase Vendimi Nr. 349/2022 i datës 28.12.2022, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 18.01.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 18.01.2023.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Vendimi Nr. 349/2022 i datës 28.12.2022, është dokument përmbartues dhe i përshtatshëm për përmbartim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “*Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, ndërsa një dokument përmbartimor për të shërbyer si titull përmbartues patjetër duhet të përmbaj elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbartimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimi Nr. 349/2022 i datës 28.12.2022 është dokument i përmbartueshëm dhe i cili vendim është i plotfuqishëm dhe është i ekzekutueshëm nga data 18.01.2023, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbartim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri* ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbartueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë* ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbartim. Arsye këto

nga te cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë të paargumentuara dhe si të tilla mbeten vetëm në natyrën deklarative, të pambështetura në prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se lidhur me këtë çështje ka iniciuar procedurë ankimore në organet administrative, mirëpo gjeti se bazuar në dispozitën e nenit 24 par. 3 të LPP-së, Vendimi Nr. 349/2022 i datës 28.12.2022, përbën dokument përmbarimor.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVË-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.371/24, me datë 18.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri